



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 36 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 4095 prot., datë 05.08.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Referuar nenit 23 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, organi kompetent për ndarjen e gjyqtarëve në seksione është Këshilli i Gjykatës. Gjithashtu, Udhëzimi nr. 79, datë 30.05.2019 “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur”, ka detajuar përbërjen dhe kualifikimin e nevojshëm të gjyqtarëve për të qenë pjesë e Seksioneve për të Miturit. Në këto kushte, referuar vendimit nr. 10, datë 25.10.2023 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, gjyqtarët znj. {...}, z. {...} dhe z. {...} rezultojnë të jenë caktuar për të gjykuar çështje penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale.

Bashkëlidhur gjeni një kopje të vendimit nr. 10, datë 25.10.2023 të Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.